

Për ushtrimin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2019

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria “ **Energy Partners AL** ” Shpk është shoqëri trëgtare koncensionare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Bisnesit më datë 28/09/2009 me NIPT K92129030I. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare” dhe nga statusi i saj.

Kapitali i shoqërisë është 1.000.000 Lek i zotëruar 70% nga ortakut “Frigo Food” Shpk dhe 30% nga ortakut “Nesh” Shpk.

Administratori i shoqërisë është Z.Sokol Meqemeja.

Selia e shoqërisë ndodhet tek Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga e Elbasanit, Vila Nr.71, Tiranë.

Aktiviteti kryesorë i shoqërisë është prodhimi i energjisë elektrike.

Ne 31 Dhjetor 2018 shoqëria ka 26 punonjës (2018)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar (SKK) dhe Ligjit Nr. 9228 datë 29 Prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike.

(c) Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

(d) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

3. Politikat kontabël

(a) Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 Dhjetor 2018 është i detajuar si më poshtë:

| | |
|-------------------------|-------------|
| Kursi i këmbimit | <u>2018</u> |
| Euro/Lek | 121.77 |
| USD/Lek | 108.64 |

(b) Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozitat me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

(c) Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbatur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë së skontuara me normën efektive të interesit.

(d) Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(e) Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve cdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

(f) Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

(g) Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur cdo humbje nga zhvlerësimi.

(h) Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

(i) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë së skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amorizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(j) Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

(k) Aktivet afatgjate materiale

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjate materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndrtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, cdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëlimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e cmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërrimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material, kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm të aktiveve afatgjate materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjate materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjate materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amorizimit mbi jetën e vlerësuar të cdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qera amorizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qerasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Normat e amortizimit janë të paraqitura si më poshtë:

| | |
|------------------------------|-----|
| ▪ Ndërtesa | 5% |
| ▪ Instalime&Makineri&Pajisje | 20% |
| ▪ Mjete transporti | 20% |
| ▪ Pajisje informatike | 25% |
| ▪ Mobilje,Orendi zyresh | 20% |

(iv) Cregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjate materiale cregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjate materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operative të vitit.

(l) Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysht shumën e cfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi të blerë.

(m) Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata material dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

(n) Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

(o) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzime financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

(p) Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe cfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Normat e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15 % (2016: 15%)

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të paimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat priten të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

(q) Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritet Fiskale janë përgjegjës për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

(r) Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të pales tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë konsiderohet si palë të lidhura.

(s) Provizionet

Një provision njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjore apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukes dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të pasasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të pasasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

(t) Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare po paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provision, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

SHËNIME MBI ZËRAT E LLOGARIVE NË PASQYRAT FINANCIARE

| 4 Mjetet monetare | 2019 | 2018 |
|---|------------------|----------------|
| Mjetet monetare detajohen si me poshte: | | |
| Mjete monetare | | |
| RAIFFEISEN LEK | (1,007) | (761) |
| VENETO LEK 1 | 37,576 | 37,576 |
| VENETO LEK 2 | 947 | 947 |
| RAIFFEISEN EUR | (1,240) | 35,760 |
| VENETO EUR | 6,150 | 6,238 |
| RAIFFEISEN USD | (1,205) | 1,068 |
| SOCIETE EUR | 17,481 | 17,730 |
| ARKA në lekë | 1,712,320 | 103,195 |
| | 1,771,021 | 201,753 |

Perfaqeson vlerën e parave në arke dhe në banke. Vlerat në monedha të huaja janë rivlersuar me kursin e kembimit të Bankës së Shqipërisë në datën e mbylljes së Bilancit.

| 5 | Te drejta te arketueshme | 2019 | 2018 |
|----------|---|-------------------|-------------------|
| | Te drejta te arketueshme paraqiten si vijon: | | |
| | Kliente per mallra, produkte e sherbime | | |
| | OSHEE SHA per shitje energjie | 21,887,477 | 4,385,982 |
| | OSHEE SHA per shitje energjie fatura te papranuara | 22,589,810 | 6,801,296 |
| | | 19,384,589 | 19,060,440 |
| | Kliente te tjere | | |
| | | <u>63,861,876</u> | <u>30,247,718</u> |
| | Perfaqeson klientin e vetem te shoqeris sone "OSHEE" Sha per energjin e shitur ndaj tij dhe nje parapagim për punime. | | |
| 6 | Inventari | 2019 | 2018 |
| | Tuba 800 10 5000 L=12m | 314,256 | 314,256 |
| | | <u>314,256</u> | <u>314,256</u> |
| 7 | Shpenzime të shtyra | 2019 | 2018 |
| | Shpenzime të shtyra | 11,925,583 | 11,925,583 |
| | | <u>11,925,583</u> | <u>11,925,583</u> |
| 8 | Të drejta të tjera afatgjatë nga palet e treta | | |
| | Bio Enegy 15 Shpk | (9,540,260) | (9,676,642) |
| | Hec-I Dragostunje Shpk | 4,108,730 | 4,108,730 |
| | Building Construction Shpk | 38,780,416 | 31,179,418 |
| | Kisi Bio Energji Shpk | 4,817,246 | 4,820,936 |
| | Energy Development Group Sha | (8,829,823) | (8,797,581) |
| | ENERGY PLUS SHPK | (83,600) | (83,600) |
| | Clean Energy AL Shpk | 54,080 | 54,080 |
| | Military System Trade Company Shpk | 17,340 | 17,340 |

| | | |
|----------------|-------------------|-------------------|
| Sokol Meqemeja | 41,486,100 | 22,444,725 |
| | <u>70,810,229</u> | <u>44,067,405</u> |

AKTIVET AFATGJATA

| | | |
|--|--------------------|--------------------|
| 9 Aktive Agatgjata Materiale | 2019 | 2018 |
| Instalime teknike,makineri,pajisje, instrumente dhe vegla pune | 1,203,263 | 1,504,079 |
| Mjete transporti | 267,617 | 337,861 |
| Koncesion i Hece-ve - Rrype, Cerruje 1 dhe Cerruje 2 | 604,034,152 | 665,321,206 |
| | <u>605,505,032</u> | <u>667,163,146</u> |

1 2 DETYRIMET AFATASHKURTRA

| | | |
|--|--------------|--------------|
| Titujt e huamarrjes | 2019 | 2018 |
| Titujt e huamarrjes – Raiffeisen Bank USD | | 572 |
| Titujt e huamarrjes - Intesa San Paolo-EUR | 5,630 | 5,618 |
| | <u>5,630</u> | <u>6,190</u> |

1 3 Detyrime tregtare dhe dhe te tjera

| | | |
|---|-------------|-------------|
| Detyrime tregtare dhe dhe te tjera | 2019 | 2018 |
| Shijaku shpk | 7,645,688 | 7,645,688 |
| SUBOR | 5,704,867 | 6,079,512 |
| Transplus shpk | 5,038,267 | 5,038,267 |
| GUGLER WATER GMBH | 2,883,135 | 3,072,475 |
| Kuid Shpk | 2,361,000 | 2,361,000 |
| Mario-07 shpk | 2,200,003 | 2,296,759 |
| Vaptech LTD (Marellimotori) | 2,155,223 | 2,200,003 |
| Alushi-Er shpk | 1,746,599 | 1,861,300 |

| | | |
|----------------------------|-------------------|-------------------|
| Klodi sha | 1,521,684 | 1,521,684 |
| Shega Trans Sha | 811,348 | 1,394,216 |
| Frijo Food shpk | 1,348,664 | 1,348,664 |
| Building Construction Shpk | 1,278,710 | 481,735 |
| Te tjere | 8,899,957 | 7,178,522 |
| | <u>43,595,145</u> | <u>42,479,826</u> |

1 Te pagueshme ndaj punonjesve

| | | |
|-------------------------------------|-------------------|-------------------|
| 4 | 2019 | 2018 |
| Paga dhe shperblime | 12,553,454 | 10,142,546 |
| Sigurime shoqerore dhe shendetesore | <u>1,297,567</u> | <u>757,616</u> |
| | <u>13,851,022</u> | <u>10,900,162</u> |

Perfshihet paga e administratorit e cila do te likujdohet ne vitin pasardhes dhe pagat e punonjesve muajit Dhjetor 2019. Nr mesatar prej 26 punonjesish gjate vitit 2019

1 Të pagueshme për detyrimet tatimore

| | | |
|----------------------------|-------------------|-------------------|
| 5 | 2019 | 2018 |
| Tatim burim | 219,290 | 208,198 |
| Tatim mbi fitimin | 15,829,880 | 17,874,681 |
| TVSH për tu rregulluar | (715,125) | 229,799 |
| Shteti- TVSh për tu paguar | 3,037,227 | 639,598 |
| | <u>18,371,271</u> | <u>18,952,276</u> |

Detyrimet tatimore afateshkurtra perfshin detyrimet ndaj tatimeve per vitin 2019 dhe shuma per tu rregulluar.

1 Të ardhura të shtyra

| | | |
|---|-------------------|-------------------|
| 7 | 2019 | 2018 |
| Të ardhura të periudhave të ardhme nga Grant EBRD | 38,180,307 | 48,400,620 |
| | <u>38,180,307</u> | <u>48,400,620</u> |

| | | | |
|----------|---|--------------------|--------------------|
| 1 | | | |
| 8 | Provizione afatshkurtra | 2019 | 2018 |
| | Provizionet afatshkurtra (teprica debitore) | 62,550 | 62,550 |
| | | <u>62,550</u> | <u>62,550</u> |
| 1 | | | |
| 9 | Detyrime ndaj institucioneve të kredisë | 2019 | 2018 |
| | Huamarrjet afat gjate –Veneto Banka | 291,813,167 | 295,981,706 |
| | Huamarrjet afat gjate –BERZH(EBRD) | 132,938,414 | 168,546,808 |
| | | <u>424,751,580</u> | <u>464,528,514</u> |
| 2 | | | |
| 0 | Të tjera të pagueshme | 2019 | 2018 |
| | Interesa pasive te llogaritura-BERZH | 2,302,419 | 2,919,137 |
| | Interesa pasive te llogaritura-Veneto Banka | 31,947,866 | 19,108,526 |
| | | <u>34,250,285</u> | <u>22,027,662</u> |
| 2 | | | |
| 1 | Të tjera të pagueshme (Pale e lidhur) | 2019 | 2018 |
| | Të drejta dhe detyrime ndaj ortakut “Frigo Food” Shpk | 184,911,201 | 186,316,430 |
| | | (16,485,256) | (12,636,306) |
| | Të drejta dhe detyrime ndaj ortakut “NESH” Shpk | | |
| | | <u>168,425,944</u> | <u>173,680,124</u> |
| | KAPITALI | 2019 | 2018 |
| 2 | | | |
| 2 | Kapitali Aksioner | | |

| | | |
|---------------------------------|---------|---------|
| Kapital i paguar nga FRIGO FOOD | 700,000 | 700,000 |
| Kapital i paguar nga NESH | 300,000 | 300,000 |

| | | |
|--|------------------|------------------|
| | <u>1,000,000</u> | <u>1,000,000</u> |
|--|------------------|------------------|

PASQYRA E PERFORMANCËS (Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve)

| | 2019 | 2018 |
|---|--------------------|--------------------|
| 2 Shitjet shoqerisë | | |
| 3 OSHEE SHA vlera Neto (Duke zbritur fee koncesionare) | 132,555,813 | 199,045,242 |
| | <u>132,555,813</u> | <u>199,045,242</u> |
| Te ardhura nga shitja e energjis elektrike per vitin 2019 | | |
| | 2019 | 2018 |
| 2 Të ardhura të tjera të shfrytëzimit | | |
| 4 Granti EBRD | 9,443,264 | 9,893,460 |
| | <u>9,443,264</u> | <u>9,893,460</u> |
| 2 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | 2019 | 2018 |
| 5 Lëndë djegëse | 707,344 | 721,061 |
| Te tjera | 210,689 | 13,000 |
| | <u>918,033</u> | <u>734,061</u> |
| 2 Shpenzime personeli | 2019 | 2018 |
| 6 Analiza e shpenzimeve te personelit si me poshte: | | |
| Pagat gjate vitit | 10,649,160 | 10,768,975 |
| Shpenzime e sigurimeve shoqerore | <u>1,720,129</u> | <u>1,731,288</u> |
| | <u>12,369,289</u> | <u>12,500,263</u> |
| 2 Shpenzime të tjera shfrytëzimi | 2019 | 2018 |
| 7 Ne ketee ze jane e perfshihen : | | |

| | | |
|----------------------------------|-----------|-----------|
| Qira per zyrat | 1,738,525 | 1,762,374 |
| Fee koncesionare | 3,506,268 | 5,863,828 |
| Mirembajtje & Shpenzime te tjera | 3,075,778 | 9,024,362 |

8,320,572

16,650,564

Ne kete ze jane te gjitha shpenzimet financiare te vitit 2019

| 28 Te ardhura dhe shpenzime financiare | 2019 | 2018 |
|---|--------------------|-------------------|
| Shpenzime interesi te kredise Veneto Banka | (13,108,461) | (14,912,018) |
| Shpenzime interesi te kredise BERZH | (6,309,824) | (7,785,255) |
| Fitim (Humbje) nga kursi kembimit | 9,326,332 | 43,490,620 |
| | <u>-10,091,952</u> | <u>20,793,347</u> |

Shpenzime Interesi jane interesat qe shoqeria ka paguar kundrejt Veneto Bank dhe BREZH per Huamarrjen e mare.

| 29 Fitimi/humbja nga veprimtarite e shfrytezimit | 2019 | 2018 |
|---|-------------------|--------------------|
| Gjoha nga tatimet | 199,711 | 1,109,600 |
| Kamatvonesa | | 314,179 |
| Shpenzime interesa kredie te panjohura | 13,892,300 | 2,352,202 |
| Shpenzime te vitit te kaluar | | |
| Totali i shpezimeve te pazbritshme viti 2019 | <u>14,092,011</u> | <u>3,775,981</u> |
| Fitim (humbje) para tatimit | 48,641,046 | 127,249,679 |
| Fitimi tatimor | 62,733,057 | 131,025,660 |
| Humbja e mbartur | - | - |
| Fitimi i tatueshem | <u>62,733,057</u> | <u>131,025,660</u> |
| Shpenzime te tatimit mbi fitimin 15% | 9,409,959 | 19,653,849 |
| Fitimi (humbja) neto e vitit financiar | <u>53,323,098</u> | <u>111,371,811</u> |
| Shpenzime te tatimit mbi fitimin 15% | 9,409,959 | 19,653,849 |

| | | |
|--|------------------|-------------------|
| Parapagimet e tatim fitimit | | 1,779,168 |
| Per tu paguar brenda 31 Mars 2019 | 9,409,959 | 17,874,681 |

| | | |
|--|--------------------|--------------------|
| 30 Rakordime FDP/ PASH | - | |
| Shitje total te deklaruar ne FDP TVSH | | |
| Shitje te deklaruar ne FDP qe jane te ardhura ne PASH | 132,555,811 | 199,045,242 |
| Oshee sha | 116,288,270 | 190,801,366 |
| KESH sha Vendim GJL | | 21,028,652 |
| Shtuar Oshee sha fature e paprnuar Dhjetor aktual | 23,279,186 | 7,011,645 |
| Zbritur Oshee sha fature e pranuar Dhjetor periudha e kaluar | (7,011,645) | (19,473,510) |
| Fee koncesionare Dhjetor 18 | | (117,222) |
| Konsumi I energjise I zbritur nga Oshee | | (205,689) |
| Te ardhura nga Grantet | 9,443,264 | 9,893,460 |
| Fitim nga kembimet valutore | 9,326,332 | 43,490,620 |
| Total te ardhura | 141,882,143 | 242,535,862 |

Faturat e tarifese se koncesionit nuk mund te deklarohen me vlere negative ne FDP ne shitje dhe sistemi na lejon vetem ti deklarojme si fatura blerje me TVSH te perjashtuar.


Ngjarjet pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Tiranë më 31/03/2020

HARTOI

Bilbil Zeneli



ADMINISTRATORI

Sokol Meqemeja

